



PËRFORCIM I DIALOGUT SOCIAL

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

VLERËSIM I SHËRBIMEVE TË NEVOJSHME PËR ORGANIZATËN E PUNËDHËNËSVE - OPM

Përshkrim i përgjithshëm

Në disa raporte progresi nga Komisioni Evropian flitet për nevojën që të vazhdojë zhvillimi i dialogut social mes pjesëmarrësve kryesorë në sferën ekonomike. Në këtë drejtim, Organizata Ndërkombëtare e Punës ndihmon vendin tonë në përpjekjet për të avancuar dialogun social si një element thelbësor i Modelit Evropian Social, që promovon konkurrencë, ndarje të të ardhurave, prosperitet ekonomik dhe mirëqenie sociale. Kjo ndihmë kanalizohet përmes projektit *Përforcim i Dialogut Social*, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe të implementuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit për *Përforcim të Dialogut Social* është përmirësimi i dialogut social si mënyrë për të krijuar vende të mira pune dhe numër sa më të madh sosh. Kjo do të mbërrihet përmes përmirësimeve institucionale dhe legjislative, krahas aktiviteteve për përforcimin e kapaciteteve të pjesëmarrësve nga të tre palët për angazhimin e tyre sa më të plotë në dialogun social. Projekti përbëhet nga tre komponentë konkretë, siç vijon:

Objektivi konkret 1	Pjesëmarrje më e madhe e Këshillit Ekonomiko-Social në përpilimin e agjendës për reforma nacionale ekonomike dhe sociale
Objektivi konkret 2	Pjesëmarrje më e madhe e këshillave lokale ekonomiko-sociale në formulimin dhe zbatimin e politikave lokale për punësim
Objektivi konkret 3	Efektivitet më i madh i sindikatave dhe organizatave të punës

Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë (OPM) është organizata kryesore për punësim dhe me përfaqësim më të madh në vend, duke përfaqësuar 15 sektorë që punësojnë mbi 70,000 punëtorë.

Qëllimi kryesor i OPM është të mbrojë anëtarët e vet dhe të promovojë interesin e punëdhënësve në sferën ekonomike dhe sociale. Më konkretisht, OPM merret me çështje që kanë të bëjnë me edukimin, infrastrukturën, përgjegjësinë sociale, mbrojtjen dhe shëndetin në mjedis pune, legjislacionin për çështje punësimi dhe atë social, tatimin, investimet, politikat sanksionuese, huatë, etj.

Si partner social, OPM merr pjesë në dialogun social trepalësh dhe dypalësh, në të gjitha nivelet. Si anëtare e Komisionit të Përbashkët, i cili është pjesë e Këshillit Ekonomik dhe Social Evropian (EESC), OPM informohet për progresin lidhur me procesin e anëtarësimit në BE dhe është e përfshirë në aprovimin e rekomandimeve që i jepen Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të Veriut.

Në nivel nacional, OPM është anëtare e Këshillit Ekonomik dhe Social dhe negocion marrëveshjet kolektive, shqyrton dhe aprovon propozim-ligje dhe propozim-rregullore për çështje ekonomike dhe sociale, shpreh qëndrimet dhe propozimet e veta në bazë të të cilave Kuvendi dhe Qeveria duhet të sjellin vendime për zhvillim të biznesit.





PËRFORCIM I DIALOGUT SOCIAL

Po aq me rëndësi është përfaqësimi i OPM në organet qeveritare për punësime tripalëshe, enteve sociale dhe sigurimit shëndetësor, si dhe në grupe të ndryshme pune dhe komisione që kanë të bëjnë me aktivitet afarist.

ONP dhe OPM janë organizata partnere dhe me sukses kanë bashkëpunuar në projekte të ndryshme. Së fundmi, mes tjerash, ONP mbështeti OPM në zhvillimin e një plani të fuqishëm strategjik, që do ta pozicionojë organizatën në të ardhmen. Një pjesë e këtij plani ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe promovimin e shërbimeve të reja, që janë të rëndësishme për anëtarët e OPM.

Objektivi i detyrës

Ky hulumtim do të përpiqet të japë vlerësim kritik dhe të sinqertë për llojet e shërbimeve që i duhen anëtarësisë, me qëllim që të identifikojë spektrin e shërbimeve që realisht do t'i duhen anëtarësisë dhe për të cilat do të kishin qenë të gatshëm të pagojnë. Përveç kësaj, duhet të definohen mënyrat se si këto shërbimeve të reja të kenë qëndrueshmëri.

Metodologjia e përgjithshme

Konsulenti duhet të zhvillojë një metodologji të detajuar kërkimore në konsultim të plotë me ONP dhe OPM. Fazë e obligueshme e vlerësimit përbëhet në realizimin e: 1) 15 intervistave të drejtpërdrejta dhe 2) sondazh *online* me 70 anëtarë të OPM.

Pas identifikimit të shërbimeve kyçe të cilat kërkohen, vlerësimi do të sigurojë analizë të konkurrencës (ofertën e shërbimeve të ngjashme, strategjinë e çmimeve, marketingun dhe strategjinë e shitjes dhe distribuimit) me qëllim që t'i mundësojë OPM të vlerësojë përparësitë e vërteta krahasuese dhe të propozojë plan qëndrueshmërie për shërbimet e reja.

Rezultatet e pritura

Konsulenti do të dorëzojë një raport të integruar që përfshin gjetjet dhe rekomandimet kryesore që kanë të bëjnë me shërbimet të cilat duhet të jenë prioritare për OPM, kur merret parasysh kërkesa dhe konkurrenca. Raporti poashtu do të sigurojë analizë konkurrence për tre shërbime kryesore që OPM duhet t'u japë prioritet dhe për të treja të përgatitet plan qëndrueshmërie.

Konsulenti do të punojë për së afërmi me OPM dhe nën mbikqyrje administrative dhe teknike të Ekspertit të Lartë të ONP për Punëdhënie nga njësia në Budapest.

Konsulenti do të japë sqarime sipas nevojës, do t'i inkorporojë komentet eventuale nga ONP dhe do të dorëzojë versionin final të raportit brenda afatit të paraparë nga ONP.

Në një mbledhje të përbashkët, konsulenti do t'i paraqesë gjetjet dhe rekomandimet para menaxhmentit të OPM dhe Bordit të Drejtorëve (BD).

Kohëzgjatja e detyrës

Detyra do të realizohet në periudhën prill-maj/qershor 2019.





PËRFORCIM I DIALOGUT SOCIAL

Address and deadline

Please submit your CV/reference at simjanoska@ilo.org; kalenzis@ilo.org; jovanovska@ilo.org by 2 April 2019.



This project is funded by the European Union, and implemented by the International Labour Organization